



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/301

12.09.2017

Podujevë

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 05/2015 Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, i datës 07/07/2015, si dhe kërkesës dhe nevojës për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollës së mesme të lartë ekonomike “Isa Boletini” Podujevë, drejtori i Drejtorisë për Arsim, shpall:

Konkurs plotësues për mësimdhënës për vitin shkollor 2017/2018

1. Shkolla e mesme e lartë ekonomike “Isa Boletini” Podujevë

- Katër (4) mësimdhënës për lëndë ekonomike,
- Dy (2) mësimdhënës për lëndë juridike, njëri për 10 orë mësimore në javë.

KUSHTET:

I. Kandidatët duhet t’i dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës),
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),

- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar),
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranojnë në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional, nr. 04/L-138, Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 05/2015 Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, i datës 07/07/2015.
- **Sqarim shtesë:**
 - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente,
 - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,
 - Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**
 Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>.

